



Npi – 01/108 datë: 10.06.2020

Bazuar në nenin 40.2.b. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenit 20.4, 60 dhe 61, të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Ligjin Nr.03/L-221 për Ndryshimin e plotësimit të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit mbi autorizimin e shpenzimeve të buxhetit për vitin fiskal 2020, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e katërt të rregullt, të mbajtur më: 10.06.2020, mori këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RISHIKIMIT TË BUXHETIT TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2020

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e katërt të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 10.06.2020, me shumicën e votave aprovoi Rishikimin e Buxhetit të Komunës së Shtimes për vitin 2020, me këto ndryshime si vijon:

FONDI – 10

Nga nënprogrami Inspekcioni - Shtime (kodi i nënprogramit 16613) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale, projekti Rregullimi i varrezave dhe hapësirave të gjelbëruara në të gjitha vendbanimet e Komunës së Shtimes (kodi i projektit 49935) shuma prej 30,000€ transferohet në kategorinë ekonomike, Mallra dhe Shërbime në nënprogramin Administrata dhe Personeli (kodi i nënprogramit 16307), shuma prej 20,000€ si dhe në nënprogramin e Shërbimeve Sociale - Shtime (kodi i nënprogramit 75531) shuma prej 10,000€.

Nga nënprogrami Planifikimi Urban dhe Mjedis (kodi i nënprogramit 66340) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale, projekti Rregullimi i vendndaljeve të Autobusëve (kodi i projektit 49890) shuma prej 15,000€, projekti Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i Kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Vojnovc (kodi i projektit 49886) shuma prej 25,000€ si dhe projekti, Rregullimi i trotuareve në rrugët dytësore të Shtimës dhe Lagjet, (kodi i projektit 49904) shuma prej 20,000€ transferohet në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në nënprogramin Arsime Fillor (kodi i nënprogramit 93180) shuma prej 20,000€ në Shërbimet e Shëndetësisë Primare (kodi i nënprogramit 73450) shumë prej 30,000€ si dhe Shërbimet Rezidenciale (kodi i nënprogramit 75532) shuma prej 10,000€.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj